

Universiteti i Tetovës
Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Cikli i tretë i Studimeve të Doktoraturës

UT-Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Këshilli i Mësimit të Mjekëve
UT-Факультет медицинских наук - Консультативный совет
Nr.-Bp. 22-324/1
20.02.2020 vit/rod.
Tetovë - Тетово

Fakultetit të Shkencave Mjekësore
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së
Tetovë

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Rita Alili** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Rita Alili** në përbërje: Prof. Dr Lutfi Zylbeari, Prof. Dr. Sadi Bexheti, Prof. dr Kastriot Haxhirexha, Prof. Dr Nexhbedin Beadini, Prof. Dr Nasir Bexheti, Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatës **Rita Halili** paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatës **Rita Alili** me titull:
“**Incidenca dhe prevalenca e Sëmundjeve Kronike Renale në Regjionin e Pollogut në Periudhën 2010-2016**”

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës **Rita Alili** si në aspektin strukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *156 faqe, 40 figura, 13 tabela dhe 8 grafikone.*

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatës **Rita Alili** është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura.*

I. HYRJA

Tek „Hyrja,, kandidatja **Rita Alili** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmijë shkencore hulumtuese.

Insuficiencia renale kronike (IRK) paraqet gjendje klinike të shoqëruar me dëmtime progresive dhe ireversibile të indit të veshkave gjatë sëmundjeve të ndryshme të tyre dhe të traktit urinar. Insuficiencia renale paraqet reduktim kronik të debitit të filtrimit glomerular, me një rritje progresive të kreatinemisë dhe uresë. IRK mund të definohet edhe si një përmbledhje e çrregullimeve të përbashkëta biologjike dhe klinike e ashtuquajtur uremia kronike. Kjo ndodh si pasojë e humbjes progresive të funksionit të nefroneve. Në shumë raste progresi, ritmi të dëmtimit të funksionit të veshkave është një proces i heshtur dhe pacienti nuk ka njohuri se në veshkat e tij është duke vepruar një sëmundje serioze me pasoja ireversibile. Shpesh herë mund të ndodhë që gjatë një ekzaminimi laboratorik të vërehet se është prezente një sëmundje e veshkave, e cila ka ecuri drejtë uremisë. Mirëpo një numër studimesh kanë dokumentuar se edhe pse IRK përparon në mënyrë progresive, nuk është patjetër që ajo të përfundojë me uremi, sepse ekzistojnë raste kur kemi ruajtje të funksionit renal në periudha shumë të gjata kohore dhe kjo formë e IRK trajtohet si insuficiencë renale kronike joprogressive (joprogressive). Mirëpo në ecurinë dhe progresin e insuficiencës renale kronike ndikojnë edhe faktorë të tjerë si: sëmundja themelore, moshë, gjinia dhe predispozicioni gjenetik etj. Ritmi i progresionit të IRK varet nga sëmundja themelore që shpie deri në dëmtime të indit renal dhe nefroneve . Në vitin 2000 Fondacioni Nacional i Veshkave në SHBA formoi një grup ekspertësh nga fusha e nefrologjisë, pediatriisë, epidemiologjisë, laboratorisë, nutricionizmit, mjekësisë sociale dhe mjekësisë familjare për përgatitjen e udhëzimeve klinike dhe praktike për definicionin e sëmundjes kronike të veshkave dhe klasifikimin e fazave të saja të njohura si udhëzimet K/DOQI (Dialysis Outcomes Quality Initiative) që udhëhiqen nga parimet: mjekësia e bazuar në fakte. Shkaktarë, kryesor i insuficiencës renale kronike është reduktimi i filtrimit glomerular (FG) pavarësisht nga sëmundja themelore. Përcaktimi i filtrimit glomerular (FG) bëhet nëpërmjet të përcaktimit të klirensit të kreatininës. Metoda më e saktë për përcaktimin e filtrimit glomerular është klirensi renal i Inulinës ose metodat radioizotope me ^{99m}Tc - DTPA (Diethylenetriamine-penta-acidum aceticum) dhe $^{51}\text{CrEDTA}$ (Ethylenediaminetetra-acidum aceticum). Përveç këtyre dy metodave

radioizotopike, në praktikën e përditshme për përcaktimin e FG ekzistojnë edhe disa lloje të metodave me ndihmë e të cilat shumë shpejtë mund të përcaktohet filtrimi glomerular.

Etiologjia e IRK është e ndryshme dhe multifaktoriale (sëmundjet renale mund të jenë të lindura / trashëguara dhe të fituara) e cila shpie deri në humbje graduale, progresive, totale dhe irreversible të funksionit të veshkave. Sëmundjet renale shpesh janë me karakter kronik dhe kryesisht me ecuri progresive. IRK mund të jetë pasojë e sëmundjeve që e dëmtojnë parenkimën e veshkës ose që krijojnë obstrukcion të traktit urinar. Sëmundja kronike e veshkave (IRK) është një barrë shëndetësore globale me një kosto të lartë ekonomike për sistemet shëndetësore dhe është një faktor i pavarur rreziku për sëmundjen kardiovaskulare (SKV). Të gjitha fazat e IRK janë të lidhura me rritjen e rrezikut të sëmundshmërisë kardiovaskulare, vdekshmërisë së parakohshme dhe / ose zvogëlimit të cilësisë së jetës. IRK është zakonisht asimptomatike deri në fazat e mëvonshme dhe mungojnë të dhënat e sakta të prevalencës.

II. QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,**” kandidatja **Rita Halili** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtijë punimi.

Rezultatet e fituara,prevalenca globale e IRK të jetë në rritje duke u bazuar edhe nga numri pacientëve me IRK në regjionin e Tetovës që viteve të fundit kërkojnë trajtim me terapi zëvedësuese dhe të jenë në përputhshmëri me rezultatet e publikuara mbi prevalencën e IRK në Ballkan, Evropë dhe Botë.

Objektivi i punimit konsiston në marrjen e të dhënave relevante, objektive dhe empirike të variabileve të përcaktuara në mënyrë që të vërtetohen hipotezat e caktuara që dalin nga objektivi dhe qëllimi i hulumtimit të ndërlidhura nga interpretimi dhe vlerësimi i rezultatve të fitura nëpërmjet të ekzaminimeve të pacientëve të sëmurë.

Edhe përkundër kësaj hipoteze të përgjithshme, paraqiten edhe disa hipoteza,si :

- H.1 Pritet korelacion sinjifikant (me domethënie statistikore) ndërmjet shkallës së FG brenda kohëzgjatjes së studimit.
- H.2. Pritet korelacion sinjifikant (me domethënie statistikore) ndërmjet përqëndrimeve të parametrave të ekzaminuar dhe sëmundjes themelore .
- H.3. Priten dallime sinjifikante (me domethënie statistikore) ndërmjet përqëndrimeve të produkteve degraduese të azotit , shkallës së FG dhe terapisë me antihipertonik. H.4. Pritet korelacion sinjifikant mes parametrave të ekzaminuar hematologjik dhe periudhave të ndryshme të sëmundjes kronike të veshkave.

III. MATERIALI DHE METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese,**„ kandidatja **Rita Halili** paraqet në mënyrë decide problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese disertacionit të doktoraturës duke përshkruar në mënyrë të thuktë metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Në studim kohort-prospektiv („cross-section”) do të përdorim ditarin e kontrollimit nga mjekët primar të Shtëpisë së Shëndetit, ditarin nga Reparti i Sëmundjeve Interne, ditarin nga Reparti i Urologjisë, të dhënat nga Enti Statistikor i Tetovës dhe evidencën nga Enti Statsistikor pranë Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën 2010-2016 për pacientë të paraqitur me IRK. Pacientët do evidentohensipas gjinisë, moshës mesatare, kohëzgjatjes së mjekimit, etiologjisë së sëmundjes.

Variablat e përfshirë në hulumtim

a) Variablat e varur

- Parametrat hematologjik (Er, Hb, Htc),
- Produktet degraduese të azotit (Urea, kreatinina në serum, acidi uric)
- Elektrolitet (Na, Ca, K, PO₄)
- Shkalla e filtrimit glomerualr e përcaktuar me formulën Coccoft&Gault
- Profili i lipideve.

b) Variablat e pavarur

- Kohëzgjatja e sëmundjes, sëmundja themelore

c) Variblat relevant

- Moshë, statusi social, mënyra e ushqimit, prania e faktorëve riskant dhe gjendjeve komorbide që korelojnë dhe ndikojnë në paraqitjen e IRK.

IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „ **Rezultatet**„ kandidatja **Rita Halili** paraqet në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me osteoporozën dhe vitaminën D. Rezultatete fituara do të shërbejnë fushës së osteologjisë dhe të osteoporozës në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka paraqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks të veçantë potencojmë krahasimin e vlerave të kandidatës me vlerat referente të shumë autoreve botëror që merren me problematikën e kësaj fushe hulumtuese.

IV. PËRFUNDIMI

Tek „ **Përfundimi,**„ kandidatja **Rita Halili** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësajë lëmijë shkencore hulumtuese.

Rezultatet e fituara do të japin një kontribut të çmuar mbi incidencën dhe prevalencën e insuficiencës renale kronike, dhe do të japin një pasqyrë më reale reale mbi IRK si dukuri të shpeshtë gjatë shtatzënisë.Përcaktimi i parametrave hematologjik si indikator kryesor në diagnostifikimin e IRKdo të ndihmonte në detektimin e hershëm të IRK dhe fillimin e trajtimit të hershëm me qëllim të parandalimit të komplikimeve të IRK si pasojë e çrregullimeve hematologjike, që manifestohen gjate IRK.Pas mbledhjes dhe përpunimit statistikor të rezultateve të fituara nga parametrat e ekzaminuar hematologjik dhe produkteve degraduese të azotit,shkallës së filtrimit glomerular në perudha të ndryshme të sëmundjes dhe pritet që më mirë dhe më saktësisht të kjetësohen ndryshimet hemtologjike të cilat paraqiten dhe ndikojnë në paraqitjen e IRK, identifikimi i faktorëve.gjendjeve komorbide që më së shpeshti shpiejnë deri në IRK dhe propozimi i strategjive më të reja për kontrollimin,trajtimin dhe parandalimin e HTA.

V. BIBLIOGRAFIA

Tek ky punim doktore do të fokusohemi në literaturën më standarde më bashkëkohore dhe në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara do ta plotësojnë dhe do ti japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse do tu përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shiqar edhe nga ky aspekt ky punim do ti plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Dukë u bazuar në të dhënat së temës së punimit të disertacionit doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i disertacionit të doktoraturës do të sjellë një risi të veçantë në fushën e mjekësisë në veçanti në prevelncën e sëmundjeve kronike renale dhe tw nefrologjisw, prandaj kërkojë nga **Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore**, që ta miratojë punimin e disertacionit të doktoraturës të kandidates **Rita Alili** me titull: **“Incidenca dhe prevalenca e Sëmundjeve Kronike Renale në Regjionin e Pollogut në Periudhën 2010-2016”**.

Tetovë më, 30.01. 2020

Anëtarët e komisionit:


Prof. Dr. Lutfi Zylbeari



Prof. Dr. Sadi Bexheti



Prof. Dr Kastriot Haxhirexha



Prof. Dr. Nexhbedin Beadini



Prof. Dr. Nasir Bexheti

